



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

## **SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE**

### **në kuadër të implementimit të projektit “AR.C.H.ETHICS, “të programit URBACT IV**

Në mbështetje dhe në zbatim të Nenit 64/a e vijues, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, si dhe Kontratës për projektin “AR.C.H.ETHICS” lidhur më 01.08.2023 midis Agjencisë Kombëtare të Kohezionit Territorial dhe partnerit Kryesor të projektit Qyteti i Cesenës, Itali dhe Marrëveshja e bashkëpunimit midis partnerëve të projektit, firmosur më datë 18.08.2023 nga Bashkia Përmet, shpallet procedurat e konkurimit për vendin e lirë:

#### **Koordinator lokal për projektin “AR.C.H.ETHICS”**

##### **I-Pozicioni koordinator lokal**

##### **a-Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore**

- Të zbatoje rigorozisht objektivat dhe qëllimin e projektit.
- Të parashikojë burimet e nevojshme për të arritur objektivat dhe të menaxhojë burimet në mënyre efektive dhe efçiente duke koordinuar me departamentet përkatëse pranë bashkisë Përmet.
- Të zhvillojë dhe të menaxhojë një plan të detajuar aktivitetesh dhe plan pune bazuar në planin e përgjithshëm të aktiviteteve.
- Të menaxhojë axhendën dhe aktivitetet së bashku me ekipin e projektit, partnerët e projektit dhe palët e tjera të interesit.
- Të monitorojë progresin e projektit dhe të propozojë përshtatjet e domosdoshme sipas nevojës për përmirësime të mundshme.
- Të mbaje marrëdhënie me institucionet vendore, grupe interesi në këtë projekt për të arritur impaktin e synuar.
- Të mbajë kontakte profesionale me partnerin kryesor, Qyteti i Cesenës, me ekipin e projektit dhe me palët e treta në lidhje me projektin, burimet, dhe impaktin e synuar.
- Të asistojë grupin lokal të veprimit dhe kordinatorin e këtij grupi në hartimin e planit të veprimit duke zbatuar metodologjinë e programit URBACT IV.
- Të ndajë informacion me ekipin e projektit, përfituesit të projektit, donatorëve, etj .;
- Të përdore praktikat, teknikat dhe standardet më të mira që ekzistojnë për menaxhimin e projektit.
- Të bëjë përditësimin dhe raportimin e të gjitha informacioneve në lidhje me Projektin dhe të sigurojë që palët e interesuara të kenë qasje në të gjitha dokumentet publike të Projektit;
- Të bëjë hartimin e dokumenteve, raporteve të ndërmjetme dhe finale të kërkuara nga donatori dhe partneri kryesor i projektit.
- Të përgatisë dokumentacionin final për raportimin dhe dukshmërinë.
- Të mbështesë aktivitetet e komunikimit dhe dukshmërisë, përmbledhjet dhe produktet që do të ndahen siç duhet përmes kanaleve të përcaktuara në koordinim me ekipin dhe publikun.
- Të jetë pjesë në çdo aktivitet që do të realizohet gjatë implementimit të projektit.
- Të përgatisë cdo dokument tjetër që i kërkohet nga punëdhënësi.

- Të përfaqësoje denjësisht vlerat dhe parimet sociale dhe humane.
- Të ruajë konfidencialitetin dhe etikën profesionale

#### **b-Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara**

- Diplome të studimeve Universitare në Ekonomik, Juridik, Shkenca Shoqërore dhe fusha te ngjashme.
- Minimumi 5 vite eksperiencë të përgjithshme pune.
- Të paktën një eksperiencë të mëparshme në implementim projektesh si koordinator lokal ,projekt menaxher ose ekspert në tre vitet e fundit.
- Angazhimi i mëparshëm në implementimin e projekteve të Bashkimit Evropian do të ishte një vlerë e shtuar.
- Njohje të mirë të gjuhës angleze
- Aftësi shumë të mira komunikimi, organizimi, analitike dhe në programet kompjuterike (word, excel...)

#### **d- Orari i punës**

- 11 ditë në muaj (part-time, 50%)

#### **f- Dokumentacioni**

- Një letër interesi në gjuhën shqipe
- Një CV në gjuhën shqipe

*Dokumentacioni do të dorëzohet personalisht nga kandidatët pranë Zyrës të Burimeve Njerëzore, Bashkia Përmet në dy kopje.*

Vetëm personi i përzgjedhur do të dorëzojë gjithë dokumentacionin mbështetës për kriteret e kërkuara dhe të përmendur në CV.

#### **g- Procedura e përzgjedhjes dhe shpalljet së kandidatit fitues**

- Kandidatët të cilët kanë shprehur interes për këtë pozicion pune do të përzgjidhen nga Komisioni i Posaçëm i ngritur për këtë procedurë konkurrimi, sipas kriterëve të mëposhtme:

<b>Kriteret</b>	<b>Pikët maksimale</b>
<b>Arsimimi</b>	<b>20</b>
<b>Eksperienca</b>	<b>30</b>
<b>Letra e motivimit</b>	<b>10</b>

#### **h- Afati i dorëzimit të dokumentacionit**

- Afati për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë deri në datën 18.09.2023, ora 15:00.